



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:279713

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05521645

CAP.nr.342/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen përmbartimore të kreditorit KUR, Sh.A., “Mitrovica”, J.S.C., me seli në Komunën e Mitrovicës, kundër debitorit, A.T nga Komuna e V..., Rruga J.T, p.nr., për shkak të borxhit nga shërbimet e furnizimit me ujë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit CPP.129/2022 datë 15.02.2023, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega ne Vushtrri, me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHËT POSHTË e pa lejueshme ankesa e paraqitur nga D.T nga Komuna e V..., Rruga J.T, p.nr., e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtrri, PPP.nr.832/2021, i datës 15.12.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega ne Vushtrri, me aktvendimin e atakuar CPP.129/2022 të datës 15.02.2023, ka vendosur si në vijim: *“I REFUZOHET prapësimi i debitorit, A..T. Rr.J.T, nga V,,a, ushtruar kundër urdhërit të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa, P.nr.1299/22, të datës,27.10.2022 me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit KUR, Sh.A, me seli në Mitrovicë, për përmbartim, lidhur me borxhin në shumë prej 382.84 euro. II. Urdhëri i Përmbartuesit Privat, P.nr.1299/22, i datës 27.10.2022, mbetet në fuqi”*.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të ligjit, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, si dhe te priset aktvendimi i atakuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm: Fatura CODE:V2867, Përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin P.nr.1299/22 datë 27.10.2022, ndaj të cili urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 08.11.2022, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 21.11.2022. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin e atakuar, ka vendos që ta refuzon prapësimin e debitorit si të pabazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se duke u bazuar në nenin 69 dhe 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë, për faktin se borxhi i krijuar për debitorin, për periudhën 31.01.2021 deri më 31.08.2022, nuk është borxh i parashkuar, në nenin 360 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, përcaktohet se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti”*, ndërsa në nenpar.1.1, të këtij neni përcaktohet *“kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa sa i përket rrjedhjes së afatit të parashkrimit, në nenin 360, par.2 të të njëjtit ligj parashihet *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*, ndërsa, në rastin konkret, kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbartim me datën 27.10.2022, ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit për kërkesat e arritura gjatë vitit 2021 dhe 2022. Neni 69 par.4 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcakton se, *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, e që në rastin konkret debitori në prapësimin e tij është thirrur vetëm në parashkrimin e borxhit, e për të cilin gjykata konstatoj që nuk kemi parashkrim pasi që kreditori propozimin për përmbartim e ka parashtruar më 27.10.2023, për periudhën 31.01.2021 deri më 31.08.2022, për të cilën periudhë është bashkangjitur edhe kartela financiare e konsumatorit e datës 13.10.2022.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë Dega Vushtrri PPP.nr. 129/2022 i datës 15.02.2023, e paraqitur nga D.T , i cili nuk është palë në këtë procedurë, andaj gjen se ankesa është e pa lejuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se pa marrë parasysh që gjykata e shkallës së parë, me rastin e nxjerrjes së aktvendimit të ankimuar, ku ka vendosur ndaj prapësimit të cilin e ka nënshkruar përfaqësuesi i debitorit, por nuk dihet se kush është përfaqësues i debitorit sepse në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë prokurë të dhënë nga debitori. Mirëpo ankesa e ushtruar ndaj aktvendimit të ankimuar është paraqitur nga personi pa autorizim dhe nga personi që nuk është palë në këtë procedurë, por i njëjti në ankesë thekson se debitori A.T , ka vdekur në vitin 2001, mirëpo as në procedurë sipas prapësimit, e as sipas ankesës nuk ka prezantuar ndonjë provë shkresore për vdekjen e debitorit. Mirëpo nga parashtruesi i ankesës D.T , nuk mund të konstatohet se i njëjti ka legjitimitet apo është trashëgimtarë i debitorit tani i ndier sipas parashtruesit të ankesës apo i njëjti e ka marr përsipër këtë procedurë sepse nuk mund të vërtetohet lidhmëria apo afërsia e ushtruesit të ankesës me debitorin. Nga këto arsye rezulton se ankesa e ushtruar ndaj aktvendimit të ankimuar është e palejueshme sepse bie në kundërshtim me nenin 186 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), i cili përcakton se: *"Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës"*.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se ankesa e debitorit, e paraqitura kundër aktvendimit të ankimuar, duhet të hedhet poshtë si e palejueshme, me çka edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u mbështetur në nenin 208 dhe 209 pika a) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CAP.nr.342/2023 me datë 28.03.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci